



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 8048 Prot

Gjirokastër më 6 : 8 :2025

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 31.07.2025

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së dates. 31.07.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 31.07.2025 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:06

Marrin pjesë në mbledhje 21 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Mahmutaj, Kristidhi, Feruni, Drasa, Erion Shehaj, Leskaj, Papadhimetri, Guçe, Pandos, Aliko

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së dates 03.07.2025

2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.07.2025-31.07. 2025”.

3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.07-31.07 2025

4. P/Vendim “Për miratimin e Dokumentit të Parë të të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”

5. P/Vendim “Për miratimin e Tavanëve Buxhetore të rishikuara në Nivel Programi për PBA-në 2026-2028 në Bashkinë Gjirokastër”.

6. P/Vendim “Për një ndryshim në VKB Nr.86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025”

7. Raporti i punës së Policisë Bashkiake për 6 -muajorin e parë të vitit 2025.

8. Informacion për zbatimin e buxhetit për periudhën janar-qershor 2025.

9. Informacion mbi rezultatet e Barometrit Gjinnor në Bashkinë Gjirokastër

10. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.



Gjithashtu paraqitet edhe dy pikat shtesë të propozuara nga ekzekutivi të cilat kanë të bëjnë me
1. Vendosjen e Znj. Ruhije Bixhaku në shtëpinë e të moshuarve. “Shpresa e Jetës”, Gjirokastrë
2. Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit” për z. Viktoraq Shollo”

Znj. Isaraj :Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro rendi i ditës.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro procesverballi i mbledhjes së datës 03.07.2025.

Hidhen në votë dhe miratohen me 21 vota pro 2 p/vendimet e ndihmës ekonomike për muajin Korrik 2025.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.07. 2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin .01-31.07.2025”.

Kalohet te pika 4 e rendit të ditës.P/Vendim “Për miratimin e Dokumentit të Parë të të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”

Znj. Shehaj: Kjo pikë ka kaluar në Komisionin e Financave së bashku dhe me dy pikat në vazhdim. Janë marrë sqarimet përkatëse nga ekzekutivi për këto tre materiale dhe komisioni ka rënë dakord për shqyrtimin e tyre në mbledhjen e Këshillit.

Sqaron znj. Koko: Dokumenti i Parë i PBA-së është detyrim ligjor dhe nuk kemi ndryshime në nivelin e pagave, Ndryshimi I fundit në paga është I tetorit 2024. Janë mbajtur stabël me nivelin e 1%deri 2 % shpenzimet operative dhe ato kapitale.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro Për miratimin e Dokumentit të Parë të të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”.

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës..P/Vendim “Për miratimin e Tavanëve Buxhetore të rishikuara në Nivel Programi për PBA-në 2026-2028 në Bashkinë Gjirokastrë”.

Z. Brahimi kërkon nga Komisioni I Ekonomisë relacion për këto materiale.Kryetari I komisionit duhet të japë sqarime në këshill.

Z. Logo sqaron se komisioni është mbledhur dhe ka marrë sqarimet e duhura nga ekzekutivi dhe ia kalon këshillit për trajtim. Janë pika rutinë dhe detyrim ligjor.Ne si komision kemi marrë sqarimet e duhura, nuk jemi ekspertë të fushës.

ZNJ. Koko: Dokumenti është I gjerë dhe parashikon nivelin e të ardhurave, të shpenzimeve Objektivat janë të qarta dhe janë të mbështetura mbi dy strategji që janë parashikimi I të ardhurave, realizimi I buxhetit .

Z.Qeli: Nuk keni parashikuar më rritje pagash?

ZNJ. Koko: Nuk kemi parashikuar rritje përveç 1-2% të vjetërsisë.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro dhe një abstenim , znj Cacaj.

ZNJ. Isaraj:Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës:

Z.Hilaj: A kishte propozime për ndryshimet buxhetore Komisioni?

Z. Llogo: Nuk kishim sygjerime. Materiali ishte i qartë.



ZNJ. Koko: Materiali i referohet fondeve të papërdorura në zërin shpenzime operative dhe është planifikuar sipas kërkesave të paraqitura nga secila drejtori dhe kanë shkuar për funksionet sipas kërkesave.

Z. Brahimi: Për zjarrfikësen a janë marrë masa për blerjen e saj, apo po prisni të mbarojnë zjarret? Po për Policinë Bashkiake a është blerë mjeti?

Z. Nebiaj: Janë bërë procedurat dhe janë në process prokurimi.

Miratohet me 20 vota Për një ndryshim në VKB Nr.86, datë 12.12.2024 "Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025"

Kalohet te raporti i Policisë Bashkiake për 6 mujorin e parë të vitit 2025.

Z. Brahimi: Duke ju uruar suksese në detyrën që keni marrë unë do ngre disa probleme.

1. Situata me kavaletat e plehut dhe barit në qendër të fshatit Valare. të cilat mund të jenë burim zjarri por edhe ndotje.

2. Varrezat e fshatit Lazarat janë të thurura me ca rrjeta që nga koha kur mbillej hashashi, me një aksion 2-3 orë mund të kthehen në normalitet.

3. Që nga ndarja e tokave me ligjin 7501 kanë rrethuar e thurur edhe rrugët, duhen liruar rrugët që nga ura e Aznakut dhe deri poshtë në fusha.

Lëvizja e mjeteve brenda qytetit është kaotike.

Ju kam ngritur gjithmonë shqetesimin e daktreshës Znj.Salaj për tubat e aspirimit të një biznesi që helmon gjithë pallatin. Dërdhja e ujërave nga taracat dhe ballkonet .

Policia Bashkiake duhet të sjellë qytetin në identitet.

Z. Shpëtim Çoçka sqaron se disa nga problemet nuk janë kompetencë e Policisë Bashkiake, por kjo e fundit është në dispozicion dhe në bështetje të secilës nga drejtoritë për zgjidhjen e problemeve. Disa nga rastet si i Znj.Salaj nuk i zgjidh Policia Bashkiake por Kodi Civil. Përsa i përket trafikut në qytet keni të drejtë, por jemi në kushtet kur po ndërhyet në rrugët e qytetit dhe nuk kemi ende Planin e Mobilitetit Tabelat nuk mungojnë por ka edhe gabime në GPS dhe shpesh turistët ngatërrohen dhe sjellin probleme në rrugët e qytetit sidomos në muajt korrik dhe gusht ku fluksi është më i shtuar.

Jemi në diskutime me Policinë e Shtetit për hedhjen e gjobave në sistem dhe për trajnimin e dy ponënjësve që do të merren me këtë gjë.

Znj. Rova; Nuk e kuptoj dhe është një problem i ngritur shumë herë në Këshill bërja me një sens e rrugëve do të sillte lehtësi në qarkullim. Është diskutuar disa herë dhe nuk e di ku qëndron kjo vështirësi se dy tabela do shtohen.

Z. Hilaj: Të ngrihet një grup pune për këtë gjë

Z. Nebiaj: Nuk ka përfunduar ende Plani i Mobilitetit , duhet të mbarojë në fillim investimi që të funksionojë Plani i Mobilitetit

Z. Hilaj: Ky është raporti i punës tuaj por për punën që bëni dhe kompetencat që keni, a ka patur rritje pagash për punonjësit e Policisë Bashkiake?

Ju ve ju duhen mjete, logjistikë, uniforma trajnime të ndryshme që edhe jut ë jeni të paguar në të njëjtin nivel me punonjësit e Policisë së Shtetit.

Znj..Koko: Policia Bashkiake nuk ka përfituar nga rritja e pagave sepse bazuar në VKM për pagat , nuk futen punonjësit e Policisë Bashkiake të punonjësit civilë. Shpërblimet janë me VKM të veçantë, Kodi i punës nuk parashikon rritje .

SEKRETAR
1. GJITHS



Kalohet te informacioni për zbatim e buxhetit për 6 mujorin e parë të vitit 2025.

Z.Brahimi: Informacioni është i qartë, por unë do qëndroj te mosrealizimet.64% të ardhurat nga muzeumet kur deklarohet bum turistësh, të ardhurat nga gjobat dhe kundravajtjet në masën 24%, tarifa e gjelbërimit 153% dhe pastrimi97%.

Z. Peta: Të ardhurat nga Nj. Administrative janë në masën 87% dhe këto të dhëna janë të 6 mujorit.

Z. Brahimi:Planifikimi bëhet mbi vjetorin dhe 6 mujorin.

Kalohet te pika 9. Informacion mbi rezultatet e Barometrit Gjinator në Bashkinë Gjirokastrë.

Znj Isaraj: Ky pyetësor ka gjetje interesante në lidhje me zbatimin e ligjit për barazinë gjinore.

Zn. Anila Cacaj: Kryetare e Komisionit të Shëndetësisë dhe Barazisë Gjinore.E marr fjalën si anëtare e Aleancës së grave e cila kryesohet nga Mihare Lapa, unë si nënkryetare dhe Orgesa si sekretare saj. Jemi trajnuar nga Aleanca dhe Bashki të Forta. Edhe në këto gjetje jemi mirë në disa tregues dhe detyrime ligjore, por mbetet ende punë për të bërë. Nga 28 detyrime ligjore 13 janë realizuar plotësisht. Mund të përmirësojmë përfaqësimin e grave në njësitë administrative sepse kemi 2 nga 7 njësi. Në zbatim të ligjit barazia gjinore kërkon profesionalizëm dhe jo vetëm plotësim të kutave

z. Arianit Muho shpreh shqetësimin për komunikimin në këshill dhe të mos lihet jashtë këshilli sepse është pjesë e të gjitha aksioneve sepse është baza.

Dosja është emergjente për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve, por ligji nuk na lejon, nuk është kaluar në komision, nuk duhet të paraqitet këtu. Ka dhe raste të tjera, pse nuk i sjellin?

Znj. Isaraj: Secili nga ne bën detyrën dhe zbatojmë kompetencat që na jep ligji.Si mund të kalojë në komision pa u futurë në rendin e ditës?Deri në fund të gushtit nuk mund të priste situata në të cilën gjendej zonja.

Hidhet në votë dhe miratohet me 18 vota pro dhe një abstenim, z. Muho.P/V “Për vendosjen e Znj.Ruhije Bixhaku në shtëpinë e të moshuarve. “Shpresa e Jetës”, Gjirokastrë”.

Hidhet në votë pika e dytë shtesë dhe miratohet me 19 vota pro pika e dytë shtesë.

2. Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit” për z. Viktoraq Shollo”.

Mbyllet mbledhja nga znj Isaraj.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT
Merita Isaraj

